



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.774/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Omer Balič nga Vitimirica, Komuna Pejë, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në qendrën e votimit në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** e pasafatshme ankesa Anr.774/2021 e datës 04.11.2021, e paraqitur nga Omer Balič nga Vitimirica, Komuna Pejë, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për manipulim me votues nga jashtë vendit, për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 04.11.2021, ka pranuar një ankesë nga Omer Balič nga Vitimirica me të cilën pretendon se në ditën e votimit në vendvotimin në fshatit Vitimiric ka pasur parregullsi nga Komisionerët dhe vëzhguesit e subjektit BIP, dhe se nga këto shkelje është dëmtuar subjekti jone politik.

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës, në këtë fazë të procesit zgjedhor, gjeti se,

**Ankesa është e pasafatshme**, për këto arsye:

Paneli, vlerëson se në këtë fazë të procesit zgjedhor kur është dorëzuar ankesa në PZAP, me pretendime nga ankuesi se ka pasur parregullsi gjatë ditës së votimit nuk mund të procedohet si ankesë e afatshme, sepse në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, i LZP-së, i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256, përcaktohet se: *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”*, nga kjo rezulton se në këtë fazë të procesit zgjedhor që ndodhemi, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, për kandidatë të Kuvendit Komunal me datë 03.11.2021 mund të parashtrohen ankesa në PZAP, vetëm për rezultatet e shpallura nga KQZ-ja. Me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së, e me asnjë Rregull Zgjedhore,

nuk parashihet mundësia që të konsiderohet e lejueshme një ankesë, që ka të bëjë me parregullsitë gjatë ditës së votimit.

Paneli, vlerëson po ashtu që edhe nëse i referohemi nenit 106 paragrafi 1, të LZP-së, i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256, në të cilin përcaktohet se: “KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-it lidhur me to të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës”, nga kjo del se mund të paraqitet ankesa ne PZAP vetëm ndaj vendimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve që i publikon KQZ-ja, pas përfundimit të të gjitha procedurave. Por nuk mund të jetë një ankesë e lejueshme në këtë fazë të procesit zgjedhor pas afatit, pasi që pas publikimit të rezultateve munde të goditet vetëm vendimi për rezultatet përfundimtarë dhe jo procesi i administrimit zgjedhor në ditën e votimit.

Nga arsyet e theksuar me lart, e në kuptim të nenit 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.774/2021 më datë 06.11.2021

**Kryesuesi i Panelit**  
**Ferki Xhaferi**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.